



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:281549

Datë: 16.03.2021

Numri i dokumentit: 01596705

P.nr.71/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtari **Sulltan Dobraj** e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, në lëndën penale kundër të pandehurit Sh. D. nga fsh.k-, i akuzuar sipas PTH-ës nga Peja me aktakuzën **PP/II.nr.1748/2019 te dt.27.11.2019**, për veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragraf 1. te KPRK-ës, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë me **dt.15.03.2021** ne praninë e prokurorit te shtetit Aridana Veseli, A. K. -përfaqësuese e KEDS, dhe të pandehurit, ne te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 16.03.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Sh. D.** , i lindur me dt..... në, me banim nek-Deçan, i biri i Nezirit, me nr.personal :....., shqiptar, shtetas i Kosovës, gjendet në liri.

Ne bazë te dispozitës ligjore nga nenit 363 paragraf 1 nen paragraf 1.1 te KPPK-ës,

REFUZOHET AKTAKUZA

Për shkak se:

Më parë e gjerë me dt. 29.05.2018 në lokalin e tij lokal III “.....” në rrugën “.....” në me dashje ka siguruar shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe e ka shmangur pagesën për ato shërbime në atë mënyrën që i pandehuri është furnizuar me energjisë elektrike përmes njehsorit elektrik me numër 40863665, ndërsa e ka lidhur një kablo elektrike 5x2.5 mm me një prizë tre fazore jashtë njehsorit elektrike duke e pamundësuar regjistrimin dhe faturimin e energjisë elektrike, me çrast të dëmtuarës KEDS i ka shkaktuar dëm material.

- **me çka kishte për të kryer vepër penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1. te KPRK-së.**

- Për shkak se Prokurori ka hequr dorë nga aktakuza me **PP/II.nr.1748/2019 te dt.27,11,2019.**
- E dëmtuara KEDS- Pejë udhëzohet ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.
- Shpenzimet procedurale penale bijën në barrë te mjeteve buxhetore te kësaj gjykate.

A r s y e t i m

PTH nga Peja me aktakuzën **PP/II.nr.1748/2019 te dt.27.11.2019** ka akuzuar te pandehurin Sh. D. nga fsh.k-, për veprat penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragraf 1, ka propozuar te caktohet dhe te mbahet seanca shqyrtimit gjyqësore te administrohen te gjitha provat e duhura e me ne fund i pandehuri te shpallet fajtor dhe te dënohet ne baze te ligjit.

Gjykata me dt.15.03.2021 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor ne te cilin kanë marre pjese Prokurorja nga Prokuroria Themelore e Pejës, përfaqësuesja e te dëmtuarës KEDS dhe i pandehuri ku jen procedura disa dëshmitarë.

Prokurorja nga Prokuroria Themelore e Pejës ne atë seancë gjyqësore ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ka ndryshuar gjendja faktike, i ka propozuar gjykatës qe te ndërprehet shqyrtimi gjyqësor kundër te pandehurit Sh. D. për shkak që do të ndryshoj aktakuzën nga Sh. D. në personin Tahir Balaj i cili në kohen e kryerjes së veprës penale ka qenë shfrytëzues i lokalit Medjana, ndërsa është tërhequr nga ndjekja penale kundër të pandehurit Sh. D. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve dhe i ka tërhequr aktakuzat **PP/II.nr.1748/2019 te dt.27,11,2019.**

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur konform nenit 454 paragraf 1 te KPP-së.

Gjykata ne bazë te nenit 463 te KPPK-ës, te dëmtuarën KEDS e ka udhëzuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Nga sipërpërmendur e ne vështrim me dispozitën e nenit 358 par.2. te KPK-ës, dhe nenit 363 paragraf 1 nën paragraf 1.1 te KPP-ës, është vendosur si ne dispozitivin e aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN
P. nr.71/2020 te dt.16,03,2021

**Sekretare juridike,
Sabiha Hoxha**

**G J Y Q T A R I
Sultan Dobraj**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** Gjykatës se Apelit në Prishtinë, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:281549
Datë: 16.03.2021
Numri i dokumentit: 01596705